

**VENDIM**  
**Nr.103, datë 17.10.2011**

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE (HEC FAQEKUQ 1 DHE HEC FAQEKUQ 2)**  
**SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hp Ostrovica Energy" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues "HEC "Faqekuq 1 dhe Faqekuq 2", si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Hp Ostrovica Energy" sh.p.k. është konform "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germa "a", "b", "c", "d".

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germa "a", "b", "c", "d".

Dokumentacioni vijues grafik, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Kualifikimin e impianteve prodhues Hec "Faqekuq 1" dhe "Faqekuq 2", si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**